



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:156750

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05733936

C.nr.2591/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen kontestimore të paditëses M.N. nga Prizreni, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve Klinaku & nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit pagesa mbi bazën e përqindjes së inflacionit, vlera e kontestit 1,007.83 euro, jashtë shqyrtimit kryesor, me datë 24 maj 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses M.N. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësja të kompensohet në emër të pagesës shtesë mbi bazën e inflacionit dhe atë:

1. Për periudhën kohore 01 Gusht - 31 Dhjetor 2019, në shumën prej 53 euro;
2. Për periudhën kohore 01 Janar - Dhjetor 2020, në shumë prej 9.53 euro;
3. Për periudhën kohore 01 Janar - 31 Dhjetor 2021, në shumën prej 162 euro;
4. Për periudhën kohore 01 Janar - 21.11.2022, në shumën prej 441.78 euro.

Në shumën e përgjithshme prej 666.31 euro, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë (02.08.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Prizrenit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 134.00 euro, në afat prej 7 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

IV. REFUZOHET e pa bazuar, pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses, përtej shumës së gjykuar sikur në pikën II. të dispozitivit të aktgjykimit deri në shumën e kërkuar prej 1,007.83 euro, përkatësisht shuma prej 341.52 euro, në emër të pagesës mbi bazën e përqindjes së inflacionit.

A r s y e t i m

Paditësja M.N. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 02.08.2022, përmes të autorizuarit të saj, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Prizreni – Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që ta detyroj të paditurën për pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, duke theksuar se paditësja M.N. është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHFMU “Abdyl Frashëri” në Prizren, si asistente për fëmijë me nevoja të veçanta, dhe bazuar në nenin 35 par.10 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, është paraparë që për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e inflacionit të futet në pagë. Shuma për kompensimin sipas inflacionit në vend për periudhën kohore nga data 18.04.2017 deri ne seancën përgatitore. Po ashtu ka theksuar se edhe pas kërkesës së vazhdueshme për këto kompensime pranë të paditurës, deri më tani nuk ka marrë përgjigje. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur kërkesën e paditëses vullnetarisht, gjykatës i ka propozuar që të merr aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar.

Paditësja përmes të autorizuarit të saj më datë 09.03.2023 përmes parashtresës ka kërkuar që paditëses t’i njihet e drejta e kompensimi mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me dt. 31.12.2022, e në shumë totale prej 933.16 euro dhe kamatën e përlllogaritur për vonesë në shumën prej 74.62 euro, e në shumën e përgjithshme prej 1,007.78 euro.

I autorizuari i paditëses, përmes parashtresës së datës 27.11.2023 ka kërkuar që paditëses t’i njihet e drejta e kompensimit mbi bazën e përqindjes së inflacionit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me dt. 21.11.2022 dhe atë në shkallë të inflacionit për vitin 2017 në 1.50%, për vitin 2018 në 1.10%, për vitin 2019 në 2.70%, për vitin 2020 në 0.20%, 2021 në 3.40% dhe për vitin 2022 në 10.40% në pagën e kërkuar prej 397.01 euro e në shumë totale prej 933.17 euro dhe kamatën e përlllogaritur për vonesë në shumën prej 74.64 euro, e në shumën e përgjithshme prej 1,007.83 euro.

E paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 26.04.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar. Pretendimet e paditëses se i takon kompensimi i inflacionit është në kundërshtim me

nenin 2 paragrafi 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, sepse në këtë dispozitë shkruan qartë se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm anëtarët e Sindikatës së Arsimit-SBASHK-ut. Padiësi ushtron padi në gjykatë për realizimin e të drejtave të tyre pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren. Padia është në kundërshtim të plotë me nenin 56 të Ligjit të Punës, sepse me këtë dispozitë parashihet decidivisht se çka përfshinë paga shtesë. Andaj çështja e pagës shtesë për shkak të inflacionit siç pretendojnë padiëses nuk lejohet me ligjin e punës, i cili ligj në këtë rast është ligj i veçantë dhe e rregullon çështjen e pagës shtesë dhe rrjedhimisht ligji i veçantë në çdo çështje ka epërsi kundrejt çdo ligji apo akti nënligjor. Pretendimet e padiëses se i takon beneficioni nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, janë në kundërshtim me nenin 90 paragrafët 1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sepse sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet në mes të organizatës së punëdhënësve dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë palë nënshkruese e kësaj kontrate. Po ashtu ka theksuar se e drejta për kompensim të inflacionit është parashkruar sipas nenit 353 të LMD-së. Në fund gjykatës i ka propozuar që padinë dhe kërkesëpadinë e padiëses ta refuzoj në tërësi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, precizimit të datës 27.12.2023 si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe nenin 399 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e padiëses është pjesërisht e themeltë, andaj pa caktuar seancë gjyqësore, vendosi lidhur me kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigjes në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës numër 288/3 e datës 01.10.2021 për padiësen e lëshuar nga Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit- e paditura, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padiësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në SHFMU “Abdyl Frashëri”, si Asistente për fëmijë në nevojë të veçanta.

Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për vitin 2021 dhe 2022 vërtetohet lartësia e pagës bazë të padiëses e që është shuma prej 397.00 euro. Po ashtu gjykata bazuar në Indeksin e Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës ka vërtetuar se shkalla e inflacionit, për vitin 2022 11.6, për vitin 2021 ka qenë 3.4%, për vitin 2020,2% dhe për vitin 2019 ka qenë 2.7.6%. Gjykata provave të lartcekura ia fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se “Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka

hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë duhet të zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë (KKAK), të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 18.04.2017 dhe asaj të datës 22.01.2021, ku në nenin 35 par.10 parashihet se *“Për çdo vit të përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”,* si dhe duke u bazuar edhe në mendimin juridik të gjykatës Supreme të Kosovës nr.214/2023 date 09.10.2023 ku në pikën II parashihet që *“Punëtorët në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, dhe Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, kanë të drejtë që në pagën e tyre të futet përqindja e inflacionit marrë për bazë shkallën e inflacionit çdo vit, sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 35, pika 10 të këtyre marrëveshjeve”,* ashtu që gjykata erdhi në përfundim se në rastin konkret paditëses i takon e drejta në pagesën mbi bazën e përqindjes së inflacionit, si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë sipas përlllogaritjes së bërë në këtë mënyrë:

- Për periudhën 01.08.2019 deri me dt. 31.12.2019, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 2.7%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2019 ka qenë 397.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 53.00 euro ($397 * 2,7\% = 8.83 * 5$ muaj = 53 euro).
- Për periudhën 01.01.2020 deri me dt. 31.12.2020, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 0.2%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2020 ka qenë 397.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 9.53 euro ($397 * 0,2\% = 0.794 * 12$ muaj = 9,53 euro).
- Për periudhën 01.01.2021 deri me dt. 31.12.2021, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 3.4%, ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2021 ka qenë 397.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është 13.50 euro ($397 * 3,4\% = 13.50 * 12$ muaj = 162 euro).
- Për periudhën 01.01.2022 deri me dt. 21.11.2022, gjykata pati parasysh që shkalla e inflacionit ka qenë 11.60%, mirëpo duke u bazuar në nenin 2,1 të LPK-së Gjykata vendos brenda kërkesave të palës (ku pala paditëse ka kërkuar që ti njihet shkalla e inflacionit në 10.40 %) ashtu që duke pasur parasysh se paga bazë e paditëses në vitin 2022 ka qenë 397.00 euro, i bie që përqindja e inflacionit që është dashur të futej në pagën bazë është ($397 * 10.4\% = 41.28 * 10$ muaj = 412.88 euro) si dhe periudha 21 ditë të muajit Nëntor është 1.37. euro

sipas llogaritjes ($41.28/30 = 1.37 * 21$ ditë = 28.90 euro)= 412.88.+28.90= 441.78 euro).

Bazuar në të lartcekurat, gjykata duke iu referuar nenit 398 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, ka vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të pa bazuar pretendimin e palës paditëse sa i përket periudhës kohore për të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të inflacionit dhe atë nga data 18.04.2017 deri me datë 31.07.2019. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se kërkesa e paditëses për kompensim në emër të inflacionit për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datë 31.07.2019, apo në shumën prej 341.52 euro, është e pa bazuar, dhe shuma e llogaritur e kamatës në lartësi prej 74.68 euro.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën nën IV, gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore edhe atë në kuptim të nenit 399 paragrafi 1 të LPK-së, ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadsë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, pasi që gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të Ligjit të Punës shprehimisht theksohet që *“të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 02.08.2022. Rrjedhimisht, duke vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditëses iu ka parashkruar pjesa e kërkesës për periudhën 17.08.2017 deri më 31.07.2019. Më konkretisht, sipas llogaritjes së gjykatës, një kërkesë e tillë është parashkruar në shumën prej 300.22 euro, ndërsa paditësja e ka ndërprerë rrjedhjen e parashkrimit dhe e ka ruajtur të drejtën për të kërkuar realizimin e kërkesës së saj në procedurë gjyqësore nga data e paraqitjes së padisë respektivisht nga data 02.08.2022, në bazë të lartcekurave Gjykata duke u bazuar në listën e pagave ka konstatuar se paga bazë e paditëses është 397.00 euro dhe jo siç është kërkuar në lartësi prej 410.91 dhe mbi këtë bazë ka refuzuar kërkesën e paditëses mbi shumën e pagës bazë prej 397 euro e deri në shumën e kërkuar prej 410.91.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (02.08.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse. Lidhur me kërkesën e palës paditëse që kamata të llogaritet si në vlerën e specifikuar në precizimin e datës 27.11.2023 në shumë prej 74.65 euro, të njëjtën gjykata e gjeti si të pabazuar pasi që kjo shumë e kamatës është llogaritur sipas kërkesës kryesore të specifikuar në precizimin e datës 27.11.2023, e të cilën kërkesë gjykata e ka aprovuar pjesërisht si në pikën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kundërshtimeve të të paditurës dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453 par. 2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 31 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 135.00 euro. Gjykata nuk i ka aprovuar shpenzimet tjera të kërkuara, meqenëse kompensimi caktohet vetëm për shpenzimet e krijuara lidhur me lëndën në gjykatë. Për më tepër nuk mund të kërkohet kompensim për secilën parashtrësë të deponuar në gjykatë, duke qenë se parashtrësja gjegjësisht padia fillestare ka pasur të meta.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 398 dhe nenit 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL
C.nr.2591/2022, datë 24 maj 2024

G j y q t a r i
Shyqri Hoxha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.